RIZA	DEMIR	NANA	212207	21/10/2018	Shtetërore (0)m² E të tretëve (500) m²			56	FITNETE		AGALLIU	16	28/59	500.00	8,300	4,150,000.00	
								57	AFRIM		AGALLIU						
								58	DASHAMIR		AGALLIU						
								59	TEFERI		(CAUSHAJ) AGALLIU						
								60	MARJANA		DRASA (AGALLIU)						
GURI	DEMIR	NANA	107478	42951.00	Shtetërore (0)m² E të tretëve (500) m²			61	FITNETE		AGALLIU	17	24/93	500.00	8,300	4,150,000.00	
								62	AFRIM		AGALLIU						
								63	DASHAMIR		AGALLIU						
								64	TEFERI		(CAUSHAJ) AGALLIU						
								65	MARJANA		DRASA (AGALLIU)						
ELBASAN																	
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 3422																	
ARDJAN	MEHDI	KABASHI	2579886	31/08/2018	PRONAR			66	LUAN	MEHDI	KABASHI	18	104/2	183.90	282	51,859.80	
								67	SHPRESA	ANASTAS	KABASHI						
QARKU ELBASAN, ZVRPP ELBASAN , ZONA KADASTRALE 8527																	
HALIL	ZENEL	KOLONJARI		2010				68	ALI	XHEVDET	MIRAKU	19	1426/6	22.4	12,764	285,913.60	
								69	ISMAIL	XHEVDET	MIRAKU						
								70	MEHMET	XHEVDET	MIRAKU						
								71	PLATON	XHEVDET	MIRAKU						
								72	RUKIJE	XHEVDET	MIRAKU						
								73	ZYRA	XHEVDET	MIRAKU						
								74	AIDA	FEJZULLA	MIRAKU	20	1426/27	19.2	12,764	245,068.80	
								75	AIDA	URAN	VYSHKA						
								76	EMINE	FEJZULLA	KAPERCELLI						
								77	FATIME	XHAFERR	VYSHKA						
								78	FEJZULLA	URAN	VYSHKA						
								79	AGRON	XHEVDET	SKILJA						
								80	ALI	XHEVDET	MIRAKU						
								81	GJYSTINA	FEJZULLA	MIRAKU						
								82	ISMAIL	XHEVDET	MIRAKU						
								83	ISUF	XHEVDET	SKILJA						
								84	MARLENA	FEJZULLA	MIRAKU(KALAJA)						
								85	MEHMET	XHEVDET	MIRAKU						
								86	MELEQE	XHEVDET	SKILJA(SHEHU)						
								87	MIT'HAT	XHEVDET	SKILJA						
								88	PLATON	XHEVDET	MIRAKU						
								89	RUKIJE	XHEVDET	MIRAKU(TRUNGU)						
								90	VJOLLCA	XHEVDET	SKILJA(RRABOSHTI)						
								91	ZYHRA	XHEVDET	MIRAKU(BALTEZA)						
								92	DRITA	FEJZULLA	VYSHKA(DARDHA)						
								93	HAJRIE	FEJZULLA	VYSHKA(DELIMETA)						
LEZHE																	
QARKU_LEZHE , ZVRPP_LEZHE , ZONA KADASTRALE_8632																	
JAK	NDUE	MARKU	816912	27/06/2016	E të tretëve			94	NIKOLL	DOD	STERKAJ	21	1/40	255.00	8,511	2,170,305.00	KUFIZIM ME URDHER TE REGJISTRUESIT KERKESE PADI

Të dhënat e pasurisë së legalizuar					Gjendja juridike (pronësia)	Pjesa takuese në parcelë (m²)	Sipërfaqja për kalim pronësie (m²)	Numri I pronareve qe kompensohen	Kompensimi i Pronarëve								
Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit						Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
			Numër	Date													
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
MONDI	JAK	MARKU	817941	26/08/2016	E të tretëve			95	NIKOLL	DOD	STERKAJ	22	1/40	113.00	8,511	961,743.00	KUFIZIM ME URDHER TE REGJISTRUESIT KERKESE PADI
DURRËS																	
QARKU DURRËS ZVRPP DURRËS, ZONA KADASTRALE 3369																	
EDMOND	ISLAM	ISAKU	223286	15.09.2016	ME PRONAR			96	LAJE		DELIALLISI	23	10/164	440	3,047	1,340,680.00	
								97	IBAHIM		DELIALLISI						
ASTRIT	ISLAM	ISAKU	222656	06.09.2016	ME PRONAR			98	BUKURIJE		BIDASHI(DELIALLISI)			300	3,047	914,100.00	
								99	PETRIT		DELIALLISI						
ARBEN	KASEM	VORA	220020	12.07.2016	ME PRONAR			100	MYZEJEN		RAMA			746	3,047	2,273,062.00	
ISMET	KASEM	VORA						101	BEXHET		DELIALLISI						
BAJRAM	KASEM	VORA						102	IKBALE		MECE						
QARKU DURRËS, ZONA KADASTRALE 8515, ZVRPP DURRËS																	
PERPARIM	NAZIF	HOXHA	242039	26.05.2016	ME PRONAR			103	GENTIAN		KILA	24	5/2439	2,311.00	11,780	27,223,580.00	
BASHKIM	NAZIF	HOXHA	147097	29.02.2016	ME PRONAR			104	EQEREM		KILA						
QAMIL	TAIP	SPANESHI	147088	11.02.2016	ME PRONAR			105	GEZIM		KILA						
SAIMIR	NAZIF	HOXHA	152600	16.02.2016	ME PRONAR			106	ILJONKA		SHERO(KADISI)						
SELAMI	NAZIF	HOXHA	147096	31.03.2017	ME PRONAR			107	ADRIANA		KILA						
								108	JETMIR		KILA						
								109	ALDO		KILA						
QARKU DURRËS , ZONA KADASTRALE 8517 , ZVRPP DURRËS																	
NDREC	PRENG	CUMRAKU	280027	25/07/2018				110	FATMIR	IBRAHIM	LILA	25	157/8	725.20	3,119.00	2,261,898.80	
YLBER	VESEL	ALUSHI	144827	27/05/2016				111									
YLBER	VESEL	ALUSHI	144827	27/05/2016				112	QAZIM	ALI	CALLIKU	26	157/7	271.10	3,119.00	845,560.90	
SHKODËR																	
QARKU SHKODËR , ZONA KADASTRALE 1495, ZVRPP SHKODËR																	
BASHKIM	QAZIM	ÇOBAJ	93194	31.11.2015				113	HALIT	JAKUP	ZENELI	27	**219/8**	695	**489**	339,855.00	
ARIF	QAZIM	ÇOBAJ	92742	16.02.2015				114									
QARKU SHKODËR , ZONA KADASTRALE 8591, ZVRPP SHKODËR																	
HAKI	HASAN	FASLIJA	18770	30.06.2017				115	LUAN	SKENDER	KOPLIKU	28	**9/26**	958.4	**8,511**	8,156,942.40	
								116	YMER	SKENDER	KOPLIKU						
								117	NAMIK	SKENDER	KOPLIKU						
								118	RUZHDI	JUSUF	ANAMALI						
								119	RESHAT	JUSUF	ANAMALI						
HASAN	MUSA	RAMJA	18769	20.07.2016				120	IZET	JUSUF	ANAMALI						
								121	GJYLAFERE	SELIM	ANAMALI						
								122	GEZIM	XHEVAT	ANAMALI						
								123	MELEQE	XHEVAT	ANAMALI						
								124	ASTRIT	XHEVAT	ANAMALI						
QARKU SHKODËR , ZONA KADASTRALE 8593, ZVRPP SHKODËR																	
ALFRED	MHILL	ZEFI	93595	04.08.2015				125	ROZINA	MARK	VOCI(PEMA)	29	10/186	290	8,511	2,468,190.00	
								126	BENET	KOLE	BUSHATI						
								127	FERDINAND	LUIGJ	BUSHATI						
								128	FILIP	LUIGJ	BUSHATI						
								129	FRANÇESKINA	LUIGJ	BUSHATI						
								130	HELIDON	KOLE	BUSHATI						
								131	LUIGJINA	JAKE	BUSHATI						
								132	NATALE	LUIGJ	BUSHATI						

Të dhënat e pasurisë së legalizuar					Gjendja juridike (pronësia)	Pjesa takuese në parcelë (m²)	Sipërfaqja për kalim pronësie (m²)	Numri I pronareve qe kompensohen	Kompensimi i Pronarëve								
Emër	Atësi	Mbiemër	Leja e legalizimit						Emër	Atësi	Mbiemër	Nr. i pronave	Nr. i pasurisë	Masa e kompensimit (m²)	Çmimi (leke/m²)	Shuma - Vlera e kompensimit (lek)	Seksioni i Veçantë
			Numër	Date													
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18
								133	ROLAND	MARK	PEMA						
								134	DRANDE	GJELOSH	BICAJ						
								135	RREGJINA	FILIP	BICAJ						
								136	ALBINA	FILIP	BICAJ						
								137	ROZINA	FILIP	BICAJ						
PJETER	LULASH	KODRA	93690	06.08.2015				138	JOLANDA	FILIP	BICAJ	30	15/1050	120	8,511	1,021,320.00	
								139	BEPIN	FILIP	BICAJ						
								140	IZABELA	FILIP	BICAJ						
								141	FERDINAND	FILIP	BICAJ						
FRANG	GJON	LEKAJ	10221	02.05.2012				142	BRAHIM		RRUSTEMI						
								143	GJYLASFIJE		RRUSTEMI						
LAZER	KOL	GJEKAJ	10005	26.04.2012				144	MUHAMET		RRUSTEMI						
NDOC	NDUE	LEKAJ	11022	14.05.2012				145	QAMILE		RRUSTEMI						
GJON	RAKE	DOÇAJ	19591	29.07.2016				146	REXHEP		RRUSTEMI	31	15/333	1836.5	8,511	15,630,451.50	
GJON	MARASH	KOLAJ	19583	13.10.2015				147	SYRRIJE		RRUSTEMI						
KUJTIM	ZEF	VUKAJ	19584	27.12.2018				148	XHEMILE		RRUSTEMI						
								149	XHEVAHIRE		RRUSTEMI						
								150	MARIJE		KUJXHIJA						
LULE	SOKOL	GJELAJ	94803	10.05.2016				151	ÇEÇILJANA		KUJXHIJA						
								152	JUSTEREZA		KUJXHIJA	32	16/590	126.7	8,511	1,078,343.70	
								153	NIKOLIN		KUJXHIJA						
QARKU SHKODËR , ZONA KADASTRALE 8597, ZVRPP SHKODËR																	
								154	AFERDITA	HALIT	ANAMALI						
								155	IXHLALE	HALIT	ANAMALI						
NDOC	KOLE	BJESHKA	102231	30.03.2018				156	JANA	NASI	ANAMALI	33	1/24	352.00	8,511	2,995,872.00	
								157	VITMIRA	KUJTIM	ANAMALI						
								158	BLERIM	KUJTIM	ANAMALI						
TIRANË VERI																	
QARKU TIRANE, ZVRPP TIRANE, ZONA KADASTRALE 8330																	
								159	ALBANA	HAZIZ	HOXHA						
								160	BUJAR	RIFAT	HOXHA						
								161	DRITA	HAJREDIN	DATJA						
								162	FATIME	HAJREDIN	KULLA						
								163	FLORINDA	HAZIZ	HOXHA						
HALIL	HIDER	RAMAJ	6078	22.04.2011	PRONARE			164	GEZIME	HAZIZ	HOXHA						
								165	HAJREDIN	RIFAT	HOXHA	34	1/25	194.6	34,068	6,629,632.8	Ndalohen veprimet mbi kete pasuri deri ne zgjidhjen e problemit nga regjistrimi I parregullt ne sistemin hipotekor
								166	KAPLLAN	HAJREDIN	HOXHA						
								167	LIRIJE		HOXHA						
								168	MAJLINDA	HAZIZ	HOXHA						
								169	SKENDER	RIFAT	HOXHA						
								170	ZEMRIJE	HAJREDIN	KAZIU						

EVIDENCA SIPAS DREJTORIVE PËR KOMPENSIMIN E PRONARËVE						
Nr. rendor	**Nr. i drejtorive**	**Drejtoria**		**Nr. i pronave**	**Sipërfaqja për kompesim (m²)**	**Shuma e shpërblimit (lekë)**
1	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**
1	1	**TIRANË JUG**	Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 8380	2	67.10	4,493,619.90
Totali DrejtoriaTiranë Jug				**2**	**67.10**	**4,493,619.90**
1	2	**KAMËZ-VORË**	Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 2066	1	500.00	236,000.00
2			Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 2884	1	372.70	1,223,574.10
3			Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 1649	1	500.50	162,162.00
4			Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 1649	1	192.00	62,208.00
5			Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 1066	1	498.90	1,776,084.00
6			Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 2884	1	53.50	190,460.00
Totali Drejtoria Kamëz-Vorë				**6**	**2,117.60**	**3,650,488.10**
1	3	**TIRANË SHTESAT**	Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 8260	1	36.75	1,131,275.25
2			Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 8260	2	4.72	145,295.76
3			Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 8160	1	16.66	1,115,703.54
4			Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 8220	1	61.80	1,902,389.40
Totali Drejtoria Tiranë Shtesat				**5**	**119.93**	**4,294,663.95**
1	4	**VLORË**	Qarku Vlorë / Bashkia Vlorë / Zona kadastrale 2832	1	916.00	5,065,480.00
2			Qarku Vlorë / Bashkia Vlorë / Zona kadastrale 8602	1	440.70	4,804,952.10
3			Qarku Vlorë / Bashkia Vlorë / Zona kadastrale 8605	2	1,000.00	8,300,000.00
Totali Drejtoria Vlorë				**4**	**2,356.70**	**18,170,432.10**
1	5	**ELBASAN**	Qarku Elbasan/Bashkia Elbasan / Zona kadastrale 3422	1	183.90	51,859.80
2			Qarku Elbasan/Bashkia Elbasan / Zona kadastrale 8527	2	41.60	530,982.40
Totali Drejtoria Elbasan				**3**	**225.50**	**582,842.20**
1	6	**LEZHË**	Qarku Shkodër/Bashkia Lezhe/ Zona kadastrale 8632	2	368.00	3,132,048.00
Totali Drejtoria Lezhë				**2**	**368.00**	**3,132,048.00**
1	7	**DURRËS**	Qarku Durrës/Bashkia Durrës / Zona kadastrale 3369	1	1,486.00	4,527,842.00
2			Qarku Durrës/Bashkia Durrës / Zona kadastrale 8515	1	2,311.00	27,223,580.00
3			Qarku Durrës/Bashkia Durrës / Zona kadastrale 8517	2	996.30	3,107,459.70
Totali Drejtoria Durrës				**4**	**4,793.30**	**34,858,881.70**
1	8	**SHKODËR**	Qarku Shkodër/Bashkia Shkodër/ Zona kadastrale 1495	1	695.00	339,855.00
2			Qarku Shkodër/Bashkia Shkodër/ Zona kadastrale 8591	1	958.40	8,156,942.40
3			Qarku Shkodër/Bashkia Shkodër/ Zona kadastrale 8593	4	2,373.20	20,198,305.20
4			Qarku Shkodër/Bashkia Shkodër/ Zona kadastrale 8597	1	352.00	2,995,872.00
Totali Drejtoria Shkodër				**7**	**4,378.60**	**31,690,974.60**
1	9	**TIRANË VERI**	Qarku Tiranë/Bashkia Tiranë/ Zona kadastrale 8330	1	194.60	6,629,632.80
Totali Drejtoria TIRANË				**1**	**194.60**	**6,629,632.80**
TOTALI				**34**	**14,621.33**	**107,503,583.35**

VENDIM
Nr. 184, datë 4.4.2019

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 128, DATË 13.3.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE BAZË TË SEKTORËVE QË DO TË MBËSHTETEN E TË MASËS SË FINANCIMIT NGA FONDI I PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL, PËR VITIN 2019"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 3, e 36, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të ndryshuar, të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", dhe të shkronjës "a", të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 128, datë 13.3.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Pas shkronjës "b, të pikës 1, shtohet shkronja "c", me këtë përmbajtje:

"c) Në fondin e programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, zëri "Transfertë në buxhetet familjare" (llogaria ekonomike 606), i miratuar në buxhetin e vitit 2019 për Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, shtohet shuma prej 84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekësh për pagesat për dorëzimin e qumështit, lëndë e parë nga fermerët.".

b) Shkronja "b, e pikës 2", ndryshohet si më poshtë vijon:

"b) Dorëzim qumështi lëndë e parë, në vlerën 10 lekë për litër në pikat e përpunimit, për fermat që mbarështojnë lopë dhe/ose të imëta, kundrejt faturës tatimore të shitjes, por jo më shumë se 700 000 (shtatëqind mijë) lekë për subjekt.".

2. Fondi prej 84 000 000 (tetëdhjetë e katër milionë) lekësh përballohet nga buxheti i vitit 2019, miratuar për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, përkatësisht:

a) 32 000 000 (tridhjetë e dy milionë) lekë nga shpenzimet korente të programit 01130 "Ekzekutimi i pagesave të ndryshme";

b) 27 000 000 (njëzet e shtatë milionë) lekë nga shpenzimet korente të programit 04160 "Mbështetje për mbikëqyrjen e tregut, infrastruktura e cilësisë dhe pronësisë industriale";

c) 19 000 000 (nëntëmbëdhjetë milionë) lekë nga shpenzimet korente të programit 01110 "Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi";

ç) 6 000 000 (gjashtë milionë) lekë nga shpenzimet korente të programit 10220 "Sigurimi shoqëror".

3. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 185, datë 4.4.2019

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 933, DATË 29.12.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE TË QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 147/2014, "Për Shërbimin e Urgjencës Mjekësore", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 933, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore (QKUM) është person juridik publik buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Organika e QKUM-së të jetë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Numri i punonjësve të QKUM-së të jetë, gjithsej, 86 veta.".

b) Lidhja 1, bashkëlidhur vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Lidhja 1

	ORGANIKA E QENDRËS KOMBËTARE TË URGJENCËS MJEKËSORE	Nr.
1	**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**	1
	Sekretar	1
2	**Drejtoria e Financës, Investimeve dhe Buxhetit**	**[23]**
	Drejtori	1
2	**Sektori i Financës dhe i buxhetit**	**6**
	Përgjegjës sektori	1
	Specialistë (financë/buxhet)	3
	Llogaritar	1
	Specialist investimesh (ekonomist, inxhinier)	1
2	**Sektori i Shërbimeve Mbështetëse**	**[16]**
	Përgjegjës sektori	1
	Specialist (burime njerëzore)	1
	Specialistë (jurist)	2
	Arkivist	1
	Shoferë	3
	Sanitare	4
	Magazinier	1
	Specialist (prokurimi)	1
	Teknik i mesëm (specialitete të ndryshme)	2
3	**Drejtoria e Koordinimit të Urgjencave Mjekësore**	**[53]**
	Drejtor	1
3	**Sektori i Njësisë së Koordinimit të Urgjencave**	**[43]**
	Përgjegjës sektori (mjek)	1
	Kryeinfermier urgjence	1
	Mjekë (urgjence)	16
	Infermierë (urgjence)	25
3	**Sektori i Trajnimeve, i Certifikimeve dhe i Akreditimit**	**[4]**
	Përgjegjës sektori (shkenca mjekësore)	1
	Specialistë (shkenca mjekësore)	3
3	**Sektori i Parandalimit, Kontrollit të Cilësisë dhe Edukimit**	**[5]**
	Përgjegjës sektori (shkenca mjekësore)	1
	Specialistë (shkenca mjekësore)	4
4	**Drejtoria e Komunikimit, Statistikës dhe Regjistrit të Urgjencës**	**[8]**
	Drejtor	1
4	**Sektori komunikimit**	**[3]**
	Përgjegjës sektori	1
	Specialistë	2
	Sektori i Statistikës dhe Regjistrit të Urgjencës	**[4]**
4	Përgjegjës sektori	1
	Specialistë	2
	Operator	1
	Numri total	**86**

VENDIM
Nr. 186, datë 4.4.2019

PËR KRITERET PËR PUNËSIMIN E PUNONJËSVE TË STRUKTURAVE PËR MBROJTJEN E FËMIJËS DHE TË PUNONJËSVE QË PUNOJNË ME FËMIJËT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 45, të ligjit nr.18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fushën e veprimit të këtij vendimi përfshihen:

a) punonjësit e strukturave për mbrojtjen e fëmijës;

b) punonjësit që punojnë me fëmijët;

c) ata që kanë të drejtën të ushtrojnë profesionin e "punonjësit social" apo të "psikologut".

2. Në kuptim të këtij vendimi, punonjësit që punojnë me fëmijët janë ata punonjës, të cilët punojnë në institucione dhe struktura të tjera publike ose private, puna e të cilëve, e paguar ose vullnetare, përfshin kontakt të drejtpërdrejtë me fëmijët. Kontakti i drejtpërdrejtë mund të jetë fizik (ndarja e hapësirave të përbashkëta me fëmijët) apo nëpërmjet komunikimit verbal (i shkruar apo elektronik).

3. Punonjësit që punojnë në strukturat për mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjësit që punojnë me fëmijët duhet të plotësojnë kriteret, si më poshtë vijon:

a) Të mos jenë të dënuar me vendim të gjykatave shqiptare dhe/ose të huaja për vepra penale kundër personit, të kryera me dashje, sipas përcaktimeve në kreun II, të pjesës së posaçme, të Kodit Penal;

b) Të mos jetë marrë ndaj tyre, nga gjykatat shqiptare dhe/ose të huaja, asnjë vendim që lidhet me masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje;

c) Të kenë trajnimin dhe certifikimin në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve.

4. Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës, përveç kritereve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

a) Të ketë formim universitar si punonjës social;

b) Të ketë formim pasuniversitar ose përvojë pune në profesionin përkatës, jo më pak se dy vjet.

5. Për punonjësit që punojnë në strukturat për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësit që punojnë me fëmijët, të cilët përfshihen në fushën e veprimit të legjislacionit në fuqi për nëpunësin civil, kriteret e përcaktuara në pikat 3 dhe 4, të këtij vendimi, janë kritere shtesë, përveç atyre të përcaktuara sipas legjislacionit të nëpunësit civil.

6. Për qëllime të vërtetimit të kritereve të përcaktuara nga nenet 45, pika 1, e 49, pika 2, të ligjit nr.18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", dhe të kritereve të përcaktuara në këtë vendim, punonjësit përkatës të strukturave për mbrojtjen e fëmijës dhe punonjësit që punojnë me fëmijët duhet të plotësojnë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dëshmi të gjendjes gjyqësore, në rastin kur struktura, ku kjo dëshmi duhet të dorëzohet, nuk ka akses në sistemin e institucionit që e lëshon atë;

b) Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore, në rastin kur dëshmia e gjendjes gjyqësore duhet të dorëzohet në struktura, të cilat kanë akses në sistemin e institucionit që e lëshon atë;

c) Fotokopje të noterizuar të diplomës;

ç) Fotokopje të librezës së punës e noterizuar;

d) Dëshmi për trajnimet e kandidatit në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve dhe/ose për trajnimin dhe certifikatën në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve;

dh) Rekomandim nga punëdhënësi i mëparshëm.

7. Brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, punëdhënësit përkatës bëjnë verifikimin e plotësimit të kritereve të përcaktuara në këtë vendim për punonjësit, të cilët, në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, janë të punësuar në strukturat përkatëse dhe për ata, të cilët punojnë me fëmijët.

8. Në rast se nga verifikimi i bërë nga punëdhënësit përkatës rezulton që punonjës të caktuar nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim, punëdhënësit, brenda 3 (tre) vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, marrin masa për të siguruar plotësimin e kritereve nga punonjësit, të cilët punojnë në strukturat për mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjësit, të cilët punojnë me fëmijët.

9. Në rast se punonjësit, të cilët punojnë në strukturat për mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjësit,

të cilët punojnë me fëmijët, nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara në këtë vendim, edhe pas marrjes së masave nga punëdhënësi, marrëdhënia e punës ndërmjet tyre ndërpritet sipas legjislacionit në fuqi.

10. Ngarkohen ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës dhe strukturat për mbrojtjen e fëmijës, në nivel qendror e vendor, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 187, datë 4.4.2019

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 708, DATË 21.11.2018, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR REGJISTRIMIN DHE KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË PËRGJEGJËSE PËR TURIZMIN TË DISA PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË VIJËN BREGDETARE VLORË–SARANDË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe të neneve 34 e 41, të ligjit nr. 93/2015, "Për turizmin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 708, datë 21.11.2018, të Këshillit të Ministrave, pas pikës 1 shtohet pika 1.1, me këtë përmbajtje:

"1.1 Pronat e paluajtshme sipas pikës 1, që ndodhen në zonat në të cilat nuk ka përfunduar regjistrimi fillestar, do të regjistrohen në përgjegjësi administrimi të ministrisë përgjegjëse për turizmin, pasi të ketë përfunduar procesi i regjistrimit fillestar të pronave private në zonat kadastrale të përfshira në këtë vendim.".

2. Ngarkohen ministria përgjegjëse për turizmin dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM
Nr. 188, datë 13.3.2019

PËR OFRIMIN NGA INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË TË SHËRBIMEVE, NË PËRPUTHJE ME VEPRIMTARINË E TYRE, PËR INSTITUCIONET E QEVERISJES QENDRORE DHE INSTITUCIONET NË VARËSI TË TYRE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 9, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për prokurimin publik", të ndryshuar, dhe të neneve 18, 19 e 95, të ligjit nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore apo institucionet në varësinë e tyre të kërkojnë fillimisht, sipas nevojave, shërbime me fonde buxhetore, si konsulenca, studime apo ekspertiza nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit.

2. Për shërbimet e ofruara sipas këtij vendimi, institucionet publike të arsimit të lartë zbatojnë tarifat e miratuara sipas legjislacionit në fuqi dhe, në mungesë të tyre, miratojnë tarifa me akte të brendshme. Tarifat e miratuara me akte të brendshme duhet t'u referohen kontratave për punë të ngjashme dhe, në mungesë të tyre, t'i referohen mesatares së vlerave të tregut për shërbimin përkatës të kërkuar.

3. Bordet e administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë miratojnë tarifat për shërbimet e ofruara për institucionet e

përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, si dhe për të tretët.

4. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, nënshkruajnë kontratë shërbimi me titullarin për çështjet financiare dhe administrative të institucionit publik të arsimit të lartë.

5. Grupi i punës, mënyra e administrimit të të ardhurave dhe masa e shpërblimit të personelit akademik dhe/ose studentëve të angazhuar në ofrimin e shërbimit rregullohen me procedura të brendshme të institucionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

6. Përparësi në rastet e ofrimit të shërbimeve kanë ato IAL, të cilat kanë marrëveshje partneriteti me ministritë e linjës. Në rastet kur një shërbim ose kategori shërbimesh ofrohet nga më shumë se një IAL publik dhe nuk ka marrëveshje partneriteti, përzgjedhja nga ana e institucioneve publike duhet të kryhet bazuar mbi ofertën më të mirë.

7. Institucionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, vijojnë me procedurat e prokurimit publik, sipas legjislacionit në fuqi, në rastet kur:

a) cilësia e shërbimeve të ofruara nga institucionet publike të arsimit të lartë nuk është sipas marrëveshjes së nënshkruar;

b) shërbimet e kërkuara nuk mund të realizohen nga institucionet publike të arsimit të lartë;

c) tarifat e ofruara nga këto institucione nuk janë sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

8. Të gjitha institucionet e pavarura kanë të drejtë që, sipas nevojave të tyre, të kërkojnë shërbimet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit.

9. Ngarkohen Kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore, institucionet në varësinë e tyre dhe institucionet publike të arsimit të lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

URDHËR
Nr. 189, datë 1.4.2019

PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË VEPRIMTARISË DHE DETYRAVE TË ZËVENDËSMINISTRIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 22, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë",

URDHËROJ:

1. Zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, z. Redi Shtino, të ndjekë dhe të nënshkruajë çështjet që kanë të bëjnë me:

a) hartimin dhe zbatimin e politikave në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

b) hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor, për organizimin dhe veprimtarinë në fushat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

c) ndjekjen, monitorimin dhe konfirmimin e regjistrimeve të diplomave të ciklit të tretë në regjistrin shtetëror të gradave shkencore dhe titujve akademikë;

d) regjistrimin, monitorimin dhe konfirmimin e njohjes dhe njësimit të diplomave të ciklit të tretë të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë;

e) kryesimin dhe monitorimin e veprimtarisë së grupeve të punës për hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në zbatim të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";

f) përmbushjen e objektivave të parashikuar në Planin 300-ditor të Qeverisë, për pjesën që i përket arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

g) koordinimin me agjencitë dhe bordet përkatëse të administrimit, në varësi të Ministrisë së

Arsimit, Sportit dhe Rinisë, që mbulojnë fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

h) koordinimin me subjektet institucionale që operojnë në fushat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

i) nënshkrimin e urdhrave për miratimin e statuteve apo ndryshimeve statutore të institucioneve të arsimit të lartë;

j) monitorimin në vazhdimësi të zbatimit të standardeve dhe kritereve të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor;

k) drejtimin e komisionit për përzgjedhjen e studentëve të shkëlqyer të cilët do të ndjekin studimet e ciklit të parë, të dytë dhe studimet e doktoratës dhe drejtimin e komisionit për përzgjedhjen e nëpunësve civilë të administratës shtetërore që do të ndjekin një program 1-vjeçar, master të ciklit të dytë apo të tretë;

l) kryesimin e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;

m) koordinimin e marrëdhënieve ndërkombëtare me partnerët;

n) ushtrimin, në mungesë dhe me porosi të ministrit, të kompetencave të ministrit, në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

2. Zëvendësministri mund të kërkojë informacion me shkrim për çdo korrespondencë shkresore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, si dhe agjencive të varësisë, për çështjet në fushën e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

3. Ngarkohet zëvendësministri, që brenda 10 ditëve pune nga miratimi i këtij urdhri të detajojë planin e tij të punës. Plani i punës miratohet nga ministri.

4. Zëvendësministri për veprimtarinë javore të kryer i raporton me shkrim ministrit çdo të hënë të javës pasardhëse.

5. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrat e tjerë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, me kabinetin e ministrit dhe me drejtoritë që mbulojnë fushat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.

6. Ngarkohet stafi administrativ i ministrisë dhe institucionet e varësisë, që të asistojnë dhe mbështesin zëvendësministrin, në përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

7. Ngarkohet zëvendësministri, z. Redi Shtino, për zbatimin e këtij urdhri dhe Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, për njoftimin e urdhrit, drejtorive të ministrisë dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

URDHËR
Nr. 190, datë 1.4.2019

PËR CAKTIMIN E FUSHËS SË VEPRIMTARISË DHE DETYRAVE TË ZËVENDËSMINISTRIT NË MINISTRINË E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 22, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012 "Për organizmin dhe funksionimin e administratës shtetërore" dhe të vendimit nr. 505, datë 13.9.2017, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë",

URDHËROJ:

1. Zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Lorena Haxhiu, të ndjekë dhe të nënshkruajë çështjet që kanë të bëjnë me:

a) hartimin dhe zbatimin e politikës shtetërore në fushën e rinisë;

b) hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e rinisë;

c) përmbushjen e objektivave të parashikuar në programin e Qeverisë, për pjesën që i përket rinisë;

d) sigurimin e bashkëpunimit me organizma, institucione, donatorë dhe aktorë të tjerë, kombëtarë apo ndërkombëtarë, për realizimin e veprimtarive që synojnë përmbushjen e politikave dhe programeve për rininë;

e) bashkërendimin dhe zbatimin e programeve, projekteve dhe veprimtarive rinore në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar;

f) mbështetjen dhe përfshirjen në veprimtari rinore të të rinjve me aftësi të kufizuara dhe integrimin e tyre në jetën shoqërore nëpërmjet këtyre veprimtarive;

g) bashkërendimin dhe monitorimin e ecurisë së punës së Shërbimit Kombëtar për Rininë, në rolin e institucionit përgjegjës për zbatimin e politikës shtetërore në fushën e rinisë;

h) problematikat që parashtrohen nga organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë në Republikën e Shqipërisë;

i) ushtrimin, në mungesë dhe me porosi të ministrit, të kompetencave në fushën e rinisë;

j) përfaqësimin e Shqipërisë në bordin drejtues të Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO);

k) sigurimin e përfshirjes dhe përfaqësimin e Shqipërisë në projekte e veprimtari rinore në nivel ndërkombëtar;

l) mbajtjen e marrëdhënieve me Këshillin e Evropës, si dhe përfaqësimin e vendit në Komitetin Drejtues Evropian për Rininë (CDEJ).

2. Zëvendësministri mund të kërkojë informacion me shkrim për çdo korrespondencë shkresore të administratës në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështjet në fushën e rinisë.

3. Ngarkohet zëvendësministri, që brenda 10 ditëve nga miratimi i këtij urdhri, të detajojë planin e punës me veprimet dhe afatet konkrete për përmbushjen e detyrave të përcaktuara më sipër. Plani i punës miratohet nga ministri.

4. Zëvendësministri, për veprimtarinë javore të kryer, i raporton me shkrim ministrit çdo të hënë të javës pasardhëse.

5. Zëvendësministri bashkëpunon dhe koordinon punën me zëvendësministrat e tjerë të Arsimit, Sportit dhe Rinisë për çështje të caktuara, që konvergojnë në fushën e përgjegjësisë dhe veprimtarisë së dy ose më shumë zëvendës-ministrave.

6. Ngarkohet zëvendësministri, znj. Lorena Haxhiu, për zbatimin e këtij urdhri dhe Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve, për njoftimin e urdhrit, drejtorive të ministrisë dhe institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini

KËRKESË

Shtetasja Regina Ndreu, e datëlindjes 14.12.1974, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, shpalljen të zhdukur të vëllait të saj, shtetasit Gentian Ndreu, i datëlindjes 3.10.1973.

KËRKUESE
Regina Ndreu

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 280 lekë